



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gjiçane
Municipal Gjiçan
Gjiçan Belediyesi

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1, 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3, paragrafi 3 dhe 4 i Ligjit nr.04/L-144 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, i dt.22 Nëntor 2012, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjiçanit, në përputhje Vendimin e Kuvendit Komunal nr.01-16/5760 I dt.27.04.2011, për Shpalljen e Interesit të Përgjithshëm për qëllimin e rregullimit të infrastruktures rrugore, në harmoni me Planin Rregullues Urban “ Livadhet e Arapit” pjesa – Tregu i Gjelbër, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, për këmbimin e pronës komunale me pronën private, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit në seancën e mbajtur me date 24.09.2013, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme private për nevoja të rrugës publike “Jugu I- pjesa e II-të”

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Gjiçanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës komunale me pronën private për nevoja të rrugës publike “ Jugu I- pjesa e II-të “**, Zona Kadastrale Gjiçan.

II.

Lejohet këmbimi i ngastrave kadastrale: P-70403013-02513-2, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 436 m², te vendi i quajtur “KRIVAÇA”, klasa e kualitetit-arë e klasit 1, P-70403013-02513-3, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 350 m², te vendi i quajtur “KRIVAÇA”, klasa e kualitetit-arë e klasit 1, P-70403013-02513-4, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 350 m², te vendi i quajtur “KRIVAÇA”, klasa e kualitetit-arë e klasit 1, P-70403013-02513-5, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 350 m², te vendi i quajtur “KRIVAÇA”, klasa e kualitetit-arë e klasit 1, P-70403013-02513-6, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 350, te vendi i quajtur “KRIVAÇA”, klasa e kualitetit-arë e klasit 1, P-70403013-02513-7, lloji i njësisë-parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 350 m², te vendi i quajtur “KRIVAQA” klasa e kualitetit-arë e klasit 1, P-70403013-02513-8, lloji i njësisë – parcelë, zona-urbane, me sipërfaqe prej 791 m², te vendi i quajtur “KRIVAÇA” klasa e kualitetit-arë e klasit 1. Siperfaqja e pergjithshme e ketyre ngastrave është 2977 m² dhe evidentohet në emër të bashkëpronarëve me nga 1/6 e pjesës së pronës: Drita Haziri, Sevdije Haziri, Ibrahim Haziri, Saim Haziri, Skender Haziri dhe Sylë Haziri.

Pronat private të cekura më lartë të këmbehen me pjesët e ngastrave kadastrale si në vijim: 2252-0, 2273-0, 2275-6, 2244-2, 2251-0, 2250-0, 2248-0, 2247-0, 2246-0, 2244-3, të cilat evidentohen në emër të P.SH. Kuvendi Komunës-Gjiçan dhe gjinden te hapsira e Tregut të Gjelber.

III.

Obligohet Kryetari i Komunës, që brenda pesë ditëve të punës, pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës së Gjiçanit të bëjë kërkesë Ministrisë për Financa-ZVPP për vlerësimin e pronave të paluajtshme të cilat janë objekt i këmbimit dhe të lidhin Kontratë për këmbimin me pronaret privat të cekur në nenin II të këtij vendimi duke u bazuar në raportet e vlerësimit nga Ministria përkatëse.

IV.

Obligohet Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, që në përputhje me Planin Rregullues Urban “Livadhet e Arapit / 2013- Tregu i Gjelber”, të caktoj hapsiren sipas raporteve të vlerësimit dhe e njejta të jetë në harmoni me destinimin për Banim Kolektiv me Afarizem.

V.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë parcelimin e ngastrave Komunale sipas raportit të vlerësimit dhe propozimit të DUMM dhe pas lidhjes së kontrates mes Kryetarit të Komunës dhe pronarëve privat të bënë regjistrimin e pronave të këmbyera në Regjistrat Kadastral.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi I Kuvendit Komunal Gjilan.

VII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 16-100732

Gjilan, më 24.09.2013

Kuvendi i Komunës

Izmi ZEKA, Kryesues